

## PËRMBLEDHJA E KONTRATËS PËR SHËRBIMET FIKSE NË RRJETIN E TELEKOMIT TË KOSOVËS SH.A.

Ofruesi i Shërbimeve të komunikimeve elektronike:

Emri: Telekom i Kosovës Sh.A.  
 NUI: 811288001  
 Adresa: Lagjja Dardania p.n., Prishtinë  
 Kontakti: Tel: 0800 10000  
 Email: [info@kosovotelecom.com](mailto:info@kosovotelecom.com),  
 Faqja zyrtare: [www.kosovotelecom.com](http://www.kosovotelecom.com)  
 Rrjeti social: <https://www.facebook.com/valamobile/>

Kjo përmbledhje e kontratës, prezanton karakteristikat e shërbimeve dhe produkteve që Telekom i Kosovës i ofron nëpërmjet rrjeteve fikse të telekomunikacionit dhe synon të ndihmojë konsumatorin për të përzgjedhur shërbimin/produktin e përshtatshëm për të. Informacioni i plotë rreth shërbimeve, ofrohet në dokumente të tjera.

Informacionin e plotë për termat dhe kushtet e përgjithshme të shërbimeve fikse mund ta gjeni në faqen zyrtare të Telekomit të Kosovës: [www.kosovotelecom.com](http://www.kosovotelecom.com), si dhe në pikat shitëse të saj.

### 1. Shërbimet dhe pajisjet

1.1. Telekom i Kosovës ofron pako të ndryshme me faturim mujor të shërbimeve fikse: internet, telefoni fikse dhe shërbime audiovizive (OTT).

Pakot e shërbimeve fikse me çmimet përkatëse, të cilat i ofrohen konsumatorit janë si në vijim:

| Përmbajtja       | Telefon Fiks |         |               |                   | Internet me bakër |                          | Internet me optikë |                          |
|------------------|--------------|---------|---------------|-------------------|-------------------|--------------------------|--------------------|--------------------------|
|                  | Tel 0        | Tel 500 | Tel 20,000    | Tel Non Stop (NS) | Vetëm internet    | Internet + Tel Fiks (NS) | Vetëm internet     | Internet + Tel Fiks (NS) |
| Çmimi/muaj       | 3.99 €       | 4.49 €  | 6.99 €        | 9.99 €            | 9.99 €            | 12.99 €                  | 12.99 €            | 15.99 €                  |
| Internet në Mbps | n/a          | n/a     | n/a           | n/a               | deri në 20Mbps    |                          | deri në 100Mbps    |                          |
| Minuta në TiK    | n/a          | 50      | 20,000        | Pa limit          | n/a               | Pa limit                 | n/a                | Pa limit                 |
| Min Vala         | n/a          | 50      | 1,000         | Pa limit          | n/a               | Pa limit                 | n/a                | Pa limit                 |
| Vala CUG         | n/a          | n/a     | 1 numër mobil | n/a               | n/a               | n/a                      | n/a                | n/a                      |

| Pakot           | Përmbajtja e kanaleve televizive       | Vetëm TV | TV + internet me bakër deri në 20Mbps | TV + internet me optikë deri në 100Mbps | Qasje shtesë (1 Box max shtesë) |
|-----------------|----------------------------------------|----------|---------------------------------------|-----------------------------------------|---------------------------------|
| TV Vala START   | Kanalet: vendore + Tring               | 8.99 €   | 15.99 €                               | 18.99 €                                 | 4.00 €                          |
| TV Vala SUPER   | Kanalet: vendore + DigitAlb me sporte  | 10.99 €  | 17.99 €                               | 20.99 €                                 | 5.00 €                          |
| TV Vala PREMIUM | Kanalet: Tv Vala Start + TV Vala Super | 13.99 €  | 21.50 €                               | 24.50 €                                 | 6.00 €                          |

*Në çmime është i përfshirë Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), përveç kur konsumatori është i liruar në bazë të ligjeve në fuqi*

- o Qasje shtesë nuk ofrohet për pakot TV të kombinuara me internet deri në 20Mbps (me bakër)
- o Të gjitha pakot TV Vala ofrojnë Catch-up TV – Kthimi i kanaleve kryesore deri në 7 ditë
- o Pakot TV Vala Start dhe TV Vala Premium ofrojnë VOD – Librari të pasur me filma, seriale, dokumentarë, etj.
- o TV Vala Start dhe Super ofrohen me 4 pajisje digjitale, përdorim i njëkohshëm në 2 pajisje me max 1 TV Vala Box
- o TV Vala Premium ofrohet me 5 pajisje digjitale, përdorim i njëkohshëm në 2 pajisje me max 1 TV Vala Box
- o Pakot me qasje shtesë ofrojnë shtesë 1 pajisje digjitale, përdorim i njëkohshëm në 1 pajisje me max 1 TV Vala Box
- o Pakot me qasje shtesë nuk ofrohet në kombinim me internet deri në 20Mbps
- o Me rastin e shkëputjes së marrëveshjes depozita për TV Vala Box kthehet në llogarinë bankare të konsumatorit

1.2. Qasje në shërbimet fikse, ndër të tjera mundësohet nga pajisjet të cilat i jepen konsumatorit në shfrytëzim për qasje në shërbimet fikse, e të cilat janë pronë e TK, dhe me rastin e ndërprerjes së kontratës, konsumatori është i obliguar t'i kthejë menjëherë pajisjet, por jo më larg se pesë (5) ditë nga ndërprerja e kontratës. Në rast të moskthimit të këtyre pajisjeve apo në rastet kur pajisjet në pronësi të TK dëmtohen si rezultat i keqpërdorimit nga ana e konsumatorit, atëherë, TK do të veprojë konform formës së paraparë në kushtet e kontratës.

## 2. Afati i aktivizimit të shërbimeve

Data e aktivizimit të shërbimit do të caktohet në mes marrëveshjes midis palëve bazuar në rendin e trajtimit të kërkesave. Në lokacionet ku TK ka shtrirje të rrjetit aktivizimi i shërbimit bëhet jo më vonë se pesë (5) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës. Në rastin e lokacioneve pa shtrirje të rrjetit të TK, përpjekjet do të bëhen që aktivizimi i shërbimit të ndodhë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve. Fillimi i shërbimit nuk garantohet në rastet kur në lokacionin përkatës TK nuk ka rrjet të disponueshëm, në këto raste, kjo kontratë do të jetë e pavlefshme dhe nuk do të prodhojë efekt juridik në mes palëve kontraktuese.

## 3. Shpejtësia e shërbimeve të internetit dhe mjetet juridike

3.1. Tabela e mëposhtme tregon shpejtësinë e internetit për paketat e faturimit mujor vetëm me internet dhe/ose me shërbime të kombinuara:

| Qasja Fikse ne Internet | Shpejtësia e Shkarkimit (Deri në) |           |                   | Shpejtësia e Ngarkimit (Deri në) |           |                   |
|-------------------------|-----------------------------------|-----------|-------------------|----------------------------------|-----------|-------------------|
|                         | Max                               | Min (40%) | E zakonshme (70%) | Max                              | Min (40%) | E zakonshme (70%) |
| Int 20 (Bakër)*         | 20 Mbps                           | 11.8 Mbps | 16.2 Mbps         | 2 Mbps                           | 1.4 Mbps  | 1.6 Mbps          |
| Int 100 (Optikë)        | 100 Mbps                          | 46.3 Mbps | 74.2 Mbps         | 100 Mbps                         | 42.5 Mbps | 72.1 Mbps         |

3.2. Konsumatori duhet të informojë TK-në për mospërputhjet domethënëse dhe të vazhdueshme ose të përsëritura shpesh ndërmjet performancës aktuale të shërbimit të zgjedhur. Nëse brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve TK nuk eliminon mospërputhjen midis performancës faktike dhe nivelit të cilësisë së përcaktuar në kontratë, konsumatori ka të drejtë të ankohet në ARKEP.

## 4. Kohëzgjatja, ripërtëritja dhe përfundimi

- 4.1. Kjo kontratë lidhet për një afat fillestar të përcaktuar prej 12 (dymbëdhjetë) / 24 (njëzetë e katër) muajsh, ose më të gjatë se 24 muaj kur vjen si kërkesë ose nevojë e konsumatorit ose shprehje e lirë e vullnetit të të dyja palëve, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës prej konsumatorit.
- 4.2. TK do ta informojë konsumatorin me faturim mujor tridhjetë (30) ditë përpara, me anë të një mediumi të qëndrueshëm, për përfundimin e afatit fillestar të kontratës. Nëse konsumatori nuk e ndërpret kontratën, kjo kontratë do të rinovohet në heshtje për një periudhë të pacaktuar. Në rast të kërkesës për ndërprerje nga konsumatori, ai është i obliguar të na njoftojë së paku dhjetë (10) ditë para datës së përfundimit e afatit fillestar të kontratës.
- 4.3. Konsumatori pranon që nëse e ndërprente kontratën gjatë periudhës së detyrueshme 9-mujore nëse e ka nënshkruar kontratën për një periudhë fillestare prej 12 muajsh, ose gjatë periudhës së detyrueshme 12 mujore nëse ka nënshkruar kontratën për një periudhë fillestare prej 24 muaj, detyrohet të kompensojë TK me pagesën mujore për muajt e mbetur të periudhës së detyrueshme, sipas çmimit të plotë të pakos, duke përfshirë edhe zbritjen e përfituar apo shpërblimin shtesë.
- 4.4. Në rast se kontrata përfshinë pajisje fundore të cilat i janë dhënë konsumatorit në shfrytëzim dhe nëse konsumatori nuk kthen pajisjen fundore, atëherë, kompensimi do të llogaritet bazuar në vlerën e pajisjes fundore proporcionalisht me kohëzgjatjen e përdorimit të saj gjatë periudhës së kontratës

## 5. Karakteristikat për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara

5.1. TK ka vënë në dispozicion të përdoruesve fundorë me aftësi të kufizuara versionin në "large print" ose versionin audio të kontratës. Detajet për këtë qëllim publikohen në faqen zyrtare të Telekomit të Kosovës: [www.kosovotelecom.com](http://www.kosovotelecom.com)

## 6. Informacione tjera relevante

6.1. Me paraqitjen e kërkesës, konsumatori pranon termat dhe kushtet e përgjithshme dhe specifike, si dhe informacionet e tjera parakontraktore të disponueshme në linkun: [www.kosovotelecom.com](http://www.kosovotelecom.com)